

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“RIGHTSOLUTION”sh.p.k

Sot ne daten 01/09/2022 bazuar ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” ortaket :

ANDI BEQIRI , shtetas shqiptar ,i datelindjes 13.09.1988 ,lindur ne PUKE e banues ne Rrugen Jakup Ferri Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, eshte mbajtes i leternjofimit me nr 033379931 dhe nr. personal identifikimi I80913065G.

ILIR MATA, shtetas shqiptar ,i datelindjes 14.05.1980 ,lindur ne TIRANE e banues ne Rrugen Elbasanit Tirane , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, eshte mbajtes i leternjofimit me nr 037155244 dhe nr. personal identifikimi I00514050N.

GENTI MATA, shtetas shqiptar ,i datelindjes 25.11.1982 ,lindur ne TIRANE e banues ne Rrugen Elbasanit Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, eshte mbajtes i leternjofimit me nr 035054157 dhe nr. personal identifikimi I21125088H.

Vendosen te krijojne shoqerine.

“RIGHTSOLUTION” sh.p.k

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar quhet **“RIGHTSOLUTION” sh.p.k** dhe e ka seline ne adresen KORCE , Rruga 6 Dëshmorët, Zona kadastrale 8562, Nr.pasurie 2/550-N3.

NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

Te zhvilloj aktivitet ne fushen telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te treteve (Call Center) dhe Contac Center. Te zhvilloj aktivitet ne fushen e kerkimit dhe hedhjes se te dhenave ne sisteme informatike (data entry), per te tretet. Te zhvilloj aktivitet ne fushen e marketingut, si te sherbimeve marketing, Te zhvilloj aktivitet ne fushen e teknologjise se informacionit, konsulence ne



fushen e IT, programime software etj si dhe cdo lloj aktiviteti tjetër i cili nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të shoqërisë me përgjegjës të kufizuar **“RIGHTSOLUTION” sh.p.k** është papercaktuar, mund të shpërbehet në cdo kohë.

NENI 4

Kapitali themelues i shoqërisë 100 000 (njëqind mijë), i shprehur në 3 kuota , të kontribuara nga ortakët :

- **ANDI BEQIRI** zotëues i **1 (një) KUOTE ME VLERE 50.000** (pesëdhjetë mijë) Leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **ILIR MATA** zotëues i **1 (një) KUOTE ME VLERE 25.000** (njëzetpese mijë) Leke, që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **GENTI MATA** zotëues i **1 (një) KUOTE ME VLERE 25.000** (njëzetpese mijë) Leke, që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Ky kapital mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimit që do të marrin ortakët.

NENI 5

Administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“RIGHTSOLUTION” sh.p.k**, do të jetë **ANDI BEQIRI**, shtetas shqiptar, i datelindjes 13.09.1988, lindur në PUKË e banues në Tiranë, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me nr 033379931 dhe nr. personal identifikimi I80913065G, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi.

NENI 6

Administratori i shoqërisë së lartpërmendur, është i veshur me të gjitha atributet për drejtimin e zakonshem dhe të jashtëzakonshem të shoqërisë, pa asnjë përjashtim dhe kufizim. Ai ka mundësi të përpilojë të gjitha aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ai ka të drejtë të blejë dhe të kembejë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera. Ai kryen cdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore dhe private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet hipotekore.

Të gjitha këtotribute do të shoqërohen rast pas rasti me autorizim të vecantë nga ana e ortakëve të vetëm dhe vetëm në këto mënyrë veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.

NENI 7

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec urdhrave te vecanta qe jepen nga ortaket e vetem. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me rezultatin ekonomik, fitim-humbje, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaket e vetem te shoqerise. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor, ortaket vendosin per krijimin e fondeve te ndryshme per shoqerine si ate te akumulimit, te reserves etj.

NENI 8

Administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie ekonomiko-financiare me autorizim te ortakeve te shoqerise, me persona fizike dhe juridik, vendas apo te huaj, mbi bazen e kontratave, bazuar ne legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lekun. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

Marredheniet e shoqerise me personelin e saj do te rregullohen mbi bazen e legjislacionit te punes. Shoqeria ka te drejte te pushoje cdo punonjes te personelit nga puna per shkak te indisiplinimit ose paaftesise profesionale duke kerkuar gjithashtu demshperblimin per demin e shkaktuar shoqerise nga punonjesit per faj te tyre.

NENI 11

Ne rast prishje te shoqerise, ortaket e vetem cakton nje likujdator i cili ne fund te likujdimit paraqet bilancin e likujdimit.

NENI 12

Ky akt themelimi hartohet ne kater kopje me vlere te barabarte secila.

ORTAKET

ANDI BEQIRI

Andi BEQIRI


ILIR MATA

Ilir Mata


GENTI MATA

Genti Mata
